

VENDIM
Nr. 493, datë 21.7.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË KAVAJË DHE
CAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të 2 (dy) objekteve arsimore në Bashkinë Kavajë, në masën 325 000 000 (treqind e njëzet e pesë milionë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Rindërtimi i kopsht/çerdhe në fshatin Luz i Vogël, Bashkia Kavajë, në masën 110 000 000 (njëqind e dhjetë milionë) lekë pa TVSH;

b) Rindërtimi i kopsht/çerdhe në fshatin Golem, Bashkia Kavajë, në masën 215 000 000 (dyqind e pesëmbëdhjetë milionë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në masën 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

3. Caktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama